

PËRMBLEDHJE E PROSPEKTIT

FONDI I INVESTIMIT CREDINS PREMIUM

Përmbledhja e Prospektit përmban informacione për të cilat duhet të jeni në dijeni përpara se të investoni, përfshirë dhe informacione mbi rreziqet. Gjithashtu jeni të lutur t'i referoheni edhe variantit më të plotë të Prospektit miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Dhjetor 2019



➤ MBI FONDET E INVESTIMIT DHE FONDIN CREDINS PREMIUM

Fondet e investimit (ose sipërmarrjet e investimeve kolektive – SIK) janë instrumente investimi, të ndërtuara nga grupimi i fondeve të shumë investitorëve, e të administruara nga Shoqëria menaxhuese, me objektiv investimin e këtyre fondeve për të gjeneruar të ardhura për investitorët. Të ardhurat totale nga Fondet e investimit përbëhen nga të ardhurat nga interesat dhe fitimi/humbja nga rivlerësimi i kapitalit.

Fondi Credins Premium është SIK-u i lançuar në 1 Korrik 2016, nga Shoqëria administruuese Credins Invest sh.a. Portofoli i fondit Credins Premium është strukturuar dhe është mbajtur në përputhje me objektivat e investimit, politikën e investimit dhe tiparet e rrezikut të shprehura në Prospektin e plotë të fondit, i publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë www.credinsinvest.com.

➤ PROFILI I INVESTITORËVE

Fondi i adresohet publikut si më poshtë:


- Investitorë që kërkojnë një normë më të lartë se produktet bankare.
- Investitorë me tolerancë të ulët për risk.
- Investitorë me kursime të larta, dhe me pasuri të tjera – (*High-Net-Worth Individuals*)
- Investitorë që kërkojnë likuiditet - disponimin e investimit të bërë në para në mënyrë të menjëhershme, pa humbur interesin.
- Investitorë që investojnë në bono thesari – ku ju ofrohet menaxhimi profesional dhe likuiditeti i Fondit.
- Investitorë institucionalë që kryejnë investime financiare dhe kërkojnë të përfitojnë nga avantazhet e këtij produkti.

➤ INFORMACION MBI PERFORMANCËN

Është e këshillueshme që anëtarët e Fondit të qëndrojnë sa më gjatë në fond, në mënyrë që të përfitojnë një normë kthimi të kënaqshme nga investimi. Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Vlera Neto e Aseteve	3,789,529,368.15 ALL
Cmimi i kuotës	1,282.2909
Kohëzgjatja e Modifikuar	3.04 vjet
Kthimi nga investimi (31.12.2018 - 31.12.2019)	5.18%

Kthimi vjetor neto historik, në 31 Dhjetor 2019




Çmimi i kuotës ka rezultuar 5.18% gjatë 2019 dhe ka ndjekur një trend rritës të vazhdueshëm.

FONDI CREDINS PREMIUM

Fondi është në monedhën Lek (ALL)

Banka depozitare: Banka Amerikane e Investimeve (ABI)



➤ KARAKTERISTIKAT E FONDIT

Duke qenë se investon kryesisht në letra me vlerë të emetuara nga Republika e Shqipërisë, Fondi ka profil të ulët rreziku. Fondi nuk është një depozitë, dhe si i tillë nuk sigurohet nga ASD. Megjithatë, ai është i mirë-monitoruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Fondi nuk garanton një normë interesi të përcaktuar. Normat e interesit janë në varësi të ecurisë së tregut dhe mund të luhaten, duke ndikuar dhe në luhatjen e vlerës së investimit. Fondi aplikon një tarifë vjetore administrimi. Tarifa e koston së administrimit të Fondit do të mbahet nga Vlera Neto e Aseteve të Fondit dhe do jetë në masën 1% në vit. Tarifa e koston së administrimit i zbritet të ardhurës bruto të realizuar nga asetet e fondit.

Fondi nuk do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave me tarifë hyrëse apo tarifë largimi nga fondi dhe me asnjë nga tarifat e mëposhtme:

- kostot e mbajtjes së regjistrimit të kuotave, si dhe kostot e shpërndarjes së fitimeve;
- kostot e përgatitjes, të shtypjes dhe tarifat postare për raportet gjashëmujore dhe vjetore për mbajtësit e kuotave;
- kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospect dhe komunikimet e tjera me investitorin.
- Komisionet bankare të transferimit të fondeve nga shlyerja e kuotave.

Fondi do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave kosto të tjera si më poshtë:

- tarifa që i paguhet bankës depozitare,
- kostot e auditimit vjetor të fondit,
- tarifat dhe kostot që i paguhen AMF-së për Fondin,
- kostot dhe komisione për shit-blerje të asetëve të fondit,
- kosto vërtetimesh të posaçme.

Tarifa e koston së administrimit dhe kostot e tjera si më sipër listuar (pikat e – i), në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë maksimumin prej **1.5%** të vlerës neto të asetëve të fondit.

Një tjetër tipar i Fondit është trashëgueshmëria. Nëse anëtari ndërron jetë përpara se të marrë pagesën e të gjitha asetëve të veta, asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë. Për informacion më të detajuar, jeni të lutur t'i referoheni Prospektit në faqen zyrtare të Shoqërisë www.credinsinvest.com

➤ AVANTAZHET E FONDIT CREDINS PREMIUM

• Likuiditet i lartë

Fondi ofron likuiditet të lartë, sepse anëtarët e fondit mund të tërhiqen në çdo kohë pa penalitet dhe pa humbur interesin. Kryerja e pagesës në asete monetare, nga llogaria e Fondit në llogarinë e investitorit kryhet brenda 7 ditëve kalendarike nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje në Credins Invest.

• Investimi mund të fillojë edhe me shuma të vogla

Shuma minimale e investimit është vetëm 2,000 Lekë, dhe kjo shumë mund të rritet me një vlerë e cila është minimalisht 1,000 lekë. Gjithashtu, fondi ofron fleksibilitet, sepse investitorët mund të investojnë me shumë të menjëhershme ose me plan investimi periodik.

• Menaxhim profesional i investimeve dhe mundësi diversifikimi në investim

Fondi menaxhohet nga profesionistë, të cilët bazuar në njohuritë dhe analizat e tyre identifikojnë investimet e përshtatshme në momentin e përshtatshëm. Ky proces ndikon në performancën e çmimit të fondit. Gjithashtu, menaxhimi profesional ndikon edhe në diversifikimin e fondit. Pavarësisht ekspozimit vetëm ndaj letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, brenda këtij grupi fondi është i mirëdiversifikuar duke alokuar asetet e tij në lloje të ndryshme të letrave me vlerë, gjë të cilën nuk mund ta realizojë vetë një investitor.

- **Transparencë**

Fondi ofron transparencë të lartë. Klienti pajiset me emër përdoruesi dhe fjalëkalim, në mënyrë që të aksesojë në çdo kohë dhe pa limit llogarinë personale në fond online, ku mund të ndjekë performancën e çmimit të kuotës dhe shpërndarjen e portofolit të investimeve të fondit.

- **Normë kthimi më e lartë se produktet bankare**

Objektivi i fondit është të ofrojë një normë kthimi më të lartë se produktet bankare. Fondi e ka filluar aktivitetin e tij në Gusht 2016. Gjatë kësaj periudhe performanca ka qenë e kënaqshme dhe çmimi i kuotës ka ndjekur trend të vazhdueshëm rritës.

➤ **KU INVESTOHEN PARATË E INVESTITORËVE?**

Në përputhje me strategjinë e investimit, të prezantuar në Prospektin e Fondit, Fondi do të investojë kryesisht në instrumenta të emetuara nga Republika e Shqipërisë (bono thesari dhe obligacione). Për të arritur diversifikimin, Fondi mund të investojë shuma të moderuara dhe në obligacione korporative Shqiptare të cilat në varësi të kushteve të tregut mund të ofrojnë mundësi investimi më të mira se titujt e emtuar nga Republika e Shqipërisë.

➤ **ILUSTRIM: BLERJA E KUOTAVE**

Çmimi i kuotës në ditën e kontributit:	1,000 Lek
Kontributi:	5,000.00 Lek
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (ALL 5,000.00/ALL 1,000.00)	5 kuota

Çmimi i kuotës në një fond investimi llogaritet çdo ditë. Çdo blerje apo shlyerje kuotash në Fond do të bëhet në lekë. Vlera në para e investitorit del duke shumëzuar numrin e kuotave të tij me çmimin për kuotë.

➤ **BLERJA E KUOTAVE PAS NJË PERIUDHE KOHE:**

Çmimi i kuotës në ditën e kontributit:	1,200 Lek
Kontributi:	5,000.00 Lek
Numri i kuotave të anëtarit në Fond: (ALL 5,000.00/ALL 1,200.00)	4.167 kuota

Me të njëjtën sasi parash blen më pak kuota, pasi çmimi është rritur nga 1,000 Lekë/kuotë në 1,200 Lekë/kuotë.

➤ **TRAJTIMI FISKAL**

Taksimi i Fondit bazohet në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Të ardhurat e përfituara nga letrat me vlerë konsiderohen si burim të ardhurash i tatueshëm për efekt të aplikimit të tatimit mbi të ardhurat personale. **Investitori tatohet vetëm për vlerën e shtuar në fond.**

Shembull-Tatimi		Lekë
Kontributi në fillim të vitit		1,000,000.00
Interesa të përllogaritura për periudhën e investimit		80,000
Kthimi i investimit	8%	
Kontribute dhe interesa të përllogaritura		1,080,000
Tatimi (në likuidim)	15%	12,000
Vlera neto e aseteve në fund të periudhës së investimit në fond		1,068,000

➤ RREZIQET E INVESTIMIT NË FOND

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët

Rrezik i lartë

Përfitimet tipike më të ulëta

Përfitimet tipike më të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil të ulët rreziku, në nivelin 2. Çdo investim apo normë kthimi e caktuar shoqërohet me rrezikun përkatës. Sa më e lartë të jetë norma e kërkuar e kthimit aq më i lartë është rreziku i ndërmarrë, dhe anasjelltas. Rreziku nga normat e interesit, rreziku i kreditit dhe ai i likuiditetit janë disa nga rreziqet kryesore ndaj të cilave fondi ekspozohet. Për më tepër informacion mbi rreziqet e investimit në fond, ju ftojmë të lexoni Prospektin e publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë: www.credinsinvest.com

➤ SI KOMUNIKOJMË ME INVESTITORIN?

- 1) Website i Shoqërisë është mjaft i pasur me informacion dhe guida për publikun;
- 2) Vlera Neto e Aseteve dhe cmimi i Fondit publikohen me bazë ditore në web site;
- 3) Prospekti dhe Informacioni Kyç për Investitorin janë dokumentat kryesorë të Fondit;
- 4) Komentaret mujorë mbi ecurinë e Fondit publikohen në website;
- 5) Për çdo kërkesë për informacion shtesë çdo investitor inkurajohet të kontaktojë me analistët financiarë të Shoqërisë.

Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një fondi. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni website të shoqërisë www.credinsinvest.com.